



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2019

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, përcaktimin e procedurave për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimeve alternative, ekzekutimin e masave dhe dënimeve jo me burgim për të miturit, trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit të mbikëqyrur për të siguruar përshtatjen e tij në komunitet për riintegrimin e tij në jetën shoqërore, si dhe zbatimin e përgjithshëm të aktiviteteve të vënies në provë.

Neni 2
Misioni i Shërbimit të Provës

Veprimtaria e Shërbimit të Provës është funksion publik, që kryhet në interes të komunitetit dhe synon udhëheqjen, dhënien e ndihmës dhe përkrahjen ndaj autorit të veprës penale, rehabilitimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, uljen e rrezikut të përsëritjes së veprave penale, uljen e kostove sociale dhe kontribuon në rritjen e sigurisë shoqërore.

Neni 3 **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **“Dënime alternative”**, një prej alternativave të dënimit me burgim, të parashikuara në kreun VII, të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
2. **“Dënime jo me burgim për të miturit”**, dënimet e parashikuara në nenin 95, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit;
3. **“Masa alternative”**, masat alternative për shmangien nga ndjekja penale, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe masa shtrënguese e arrestit në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, sipas Kodit të Procedurës Penale;
4. **“Mbikëqyrje”**, aktivitetet që kryhen nga Shërbimi i Provës për zbatimin e masave alternative dhe alternativave të dënimit me burgim, si dhe urdhërimeve të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, me qëllim asistim, këshillim dhe riintegrim të të mbikëqyrurit në komunitet;
5. **“I mbikëqyrur”**, i dënuari me vendim gjyqësor me njërën prej alternativave të dënimit me burgim ose personi ndaj të cilit gjykata ka vendosur një urdhër mbrojtjeje apo ndonjë masë tjetër shtrënguese, të parashikuar me ligje të veçanta;
6. **“I mbikëqyrur i mitur”**, çdo person që ka përgjegjësi penale dhe është subjekt i drejtësisë penale për të mitur sipas këtij kodi;
7. **“Shmangie”**, masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin;
8. **“Vënia në provë”**, plotësimi i kushteve të caktuara nga organi procedues ndaj personit të vendosur nën mbikëqyrje për një periudhë të caktuar kohore. Vënia në provë përfshin një sërë aktivitetesh dhe ndërhyrjesh, të tilla si: kontrollin, orientimin dhe asistencën, me qëllim përfshirjen sociale të të mbikëqyrurit, si dhe sigurinë në komunitet;
9. **“Përkujdesje e mëtejshme”**, proces i planifikuar nga Shërbimi i Provës në bashkëpunim me të mbikëqyrurin, me pëlqimin e tij, për t’u zhvilluar edhe pas përfundimit të vënies në provë, me qëllim riintegrimin e tij në komunitet.

10. **“Punonjës të Shërbimit të Provës”**, nëpunësit e Shërbimit të Provës dhe punonjësit administrativë.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë së Shërbimit të Provës

1. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet gjyqësore, në respektim të lirive e të të drejtave themelore të njeriut, të parimit të ligjshmërisë, objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit, kontrollit dhe llogaridhënies.
2. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në respektim të standardeve të larta etike e profesionale. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Shërbimi i Provës garanton dinjitetin, integritetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të të mbikëqyrurit e të familjes së tij, të viktimës së veprës penale dhe të familjes së saj. Të gjitha aktivitetet dhe ndërhyrjet e Shërbimit të Provës janë në përputhje me standardet më të larta etike dhe profesionale, kombëtare e ndërkombëtare.
3. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në respektim të parimit të njoftimit në një gjuhë të kuptueshme nga personi, në rast se është e nevojshme, përmes një përkthyesi zyrtar apo përmes një përkthyesi të gjuhës së shenjave, nëse personi nuk flet apo nuk kupton gjuhën shqipe apo nuk mund të shprehet.
4. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në respektim të jetës private të të mbikëqyrurit dhe familjes së tij, duke kufizuar atë brenda kufijve të natyrës dhe përmbajtjes së dënimeve dhe masave të dhëna nga gjykata dhe nëse janë si rezultat i veçorive të ndërhyrjes, në varësi të faktit dhe rrezikshmërisë së veprës së kryer.
5. Shërbimi i Provës synon të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë të të mbikëqyrurit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështetë e të nxitë riintegrimin social të të mbikëqyrurit nëpërmjet shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social e ndërhyrjeve të posaçme.
6. Veprimtaria e Shërbimit të Provës realizohet në mbrojtje dhe në respektim të privatësisë e të konfidencialitetit për informacionin e mbledhur dhe të prodhuar për shkak të detyrës, parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.
7. Veprimtaria e Shërbimit të Provës zhvillohet pa asnjë diskriminim race, kombësie, etnie, gjuhe, besimi fetar, gjinie, orientimi seksual, opinionin ose përkatësi politike, pasurie, origjine sociale, moshe, paaftësie, sëmundjeje

kronike jongjitëse ose infeksion HIV/SIDA ose për rrethana të tjera të këtij lloji, përveç rasteve të diskriminimit pozitiv, në përputhje me Kushtetutën.

8. Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucionet shtetërore e joshtetërore, kombëtare ose ndërkombëtare, për të promovuar përfshirjen sociale të personave, me qëllim uljen e recidivizmit, adresimin e shtysave kriminale dhe rehabilitimin e riintegrimin e tyre.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 5

Organizimi i Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës është institucion publik e buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë, dhe gëzon personalitet juridik.
2. Struktura dhe organika e Shërbimit të Provës miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
3. Shërbimi i Provës organizohet në:
 - a) nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës;
 - b) nivel vendor, nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës të organizuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.
4. Për ushtrimin e veprimtarisë, Shërbimi i Provës ka buxhetin e vet, si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 6

Funksionet e Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës, gjatë veprimtarisë së tij, ushtron këto funksione:

- a) Mbikëqyr zbatimin e detyrave të ngarkuara ndaj personit nën mbikëqyrje, të përcaktuara në urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga prokurori;
- b) Harton dhe mbikëqyr mënyrën e zbatimit të programit individual të trajtimit të të mbikëqyrurit, duke synuar mbrojtjen e interesit publik, mbrojtjen e viktimave të veprave penale dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale;
- c) Mbështet të mbikëqyrurin në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror para, gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së provës.

- c) Adreson problematikat e të mbikëqyrurit për punësimin, strehimin, formimin e tij, në mënyrë që të reduktohet në të ardhmen rreziku i recidivizmit.
- d) Harton raporte vlerësimi pranë prokurorisë dhe gjykatës, në përputhje me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore në fuqi.

Neni 7

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës është përgjegjëse për:
 - a) planifikimin dhe drejtimin strategjik të veprimtarisë së Shërbimit të Provës;
 - b) organizimin, drejtimin e koordinimin e procesit të ekzekutimit të masave dhe dënimeve nga degët territoriale;
 - c) organizimin, drejtimin dhe koordinimin e procesit të zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Miturit;
 - ç) organizimin, drejtimin dhe koordinimin e procesit të mbikëqyrjes elektronike nga ana e Drejtorisë së Mbikëqyrjes Elektronike dhe degëve territoriale të Shërbimit të Provës, bazuar në ligjin nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”;
 - d) koordinimin dhe përgatitjen e standardeve, metodologjisë së punës, me qëllim unifikimin e praktikës e përmirësimin e veprimtarisë së punonjësve të Shërbimit të Provës;
 - dh) vlerësimin, kontrollin dhe inspektimin e aktivitetit të zhvilluar nga degët territoriale të Shërbimit të Provës;
 - e) koordinimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të Shërbimit të Provës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e Shërbimit të Provës;
 - ë) organizimin e trajnimeve profesionale të posaçme të nëpunësve dhe për koordinimin e punës për trajnime të vazhdueshme të ofruara nga institucione, donatorë ose organizata vendase apo të huaja;
 - f) mbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme, shtetërore apo private, organizata jofitimprurëse, vendase apo të huaja, për realizimin e veprimtarisë institucionale;
 - g) përfaqësimin në proceset gjyqësore, ku Shërbimi i Provës është palë;
 - gj) koordinimin e punës për mbledhjen e të dhënave statistikore në fushën e Shërbimit të Provës, përpunimin e trajtimin e mëtejshëm të tyre;
 - h) promovimin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës;
 - i) administrimin financiar të institucionit të Shërbimit të Provës;

- j) kryerjen e detyrave të tjera të nevojshme për zbatimin e masave dhe të dënimeve.

2. Rregullorja e Shërbimit të Provës miratohet nga ministri i Drejtësisë.

Neni 8

Kompetenca tokësore e degëve territoriale

1. Dega territoriale, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin i mbikëqyruri, është kompetente për realizimin e mbikëqyrjes në territorin e vet të kompetencës.
2. Dega territoriale, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi që vlerësohet, kompetente është për hartimin e raportit të vlerësimit. Nëse personi që vlerësohet ndodhet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, është kompetente dega territoriale pranë rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni i vuajtjes së dënimit.
3. Në rast konflikti kompetence ndërmjet degëve territoriale, zgjidhja e konfliktit bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni për këtë konflikt.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës në marrëdhënie me të tretët, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e saj dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës.

Neni 10

Drejtori i degës territoriale

1. Drejtori i degës territoriale është përgjegjës për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave nga punonjësit e degës territoriale të Shërbimit të Provës.
2. Drejtori i degës territoriale duhet të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “Master shkencor” / “Master i arteve” / “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji.

Neni 11

Specialisti i Shërbimit të Provës

1. Specialisti i Shërbimit të Provës është personi përgjegjës për mbikëqyrjen e masave alternative, dënimeve jo me burgim, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, alternativave të dënimit me burgim, si dhe masave të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, me qëllim asistimin, këshillimin dhe riintegrimin e të mbikëqyrurve në komunitet.
2. Specialisti i Shërbimit të Provës duhet të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “Master profesional” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji.

Neni 12

Të drejtat dhe ndalimet e punonjësve të shërbimit të provës

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës ka të drejtë të njihet me informacionin e administruar gjatë procesit hetimor dhe gjyqësor, për aq sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave funksionale e me informacionin e administruar nga institucione të tjera shtetërore, në përputhje me kushtet dhe kërkesat ligjore.
2. Punonjësi i Shërbimit të Provës nuk mund të kryejë funksione të tjera publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat e tij funksionale dhe ligjore.
3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Shërbimit të Provës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.
4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 13

Rastet e konfliktit të interesit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës, sipas legjislacionit përkatës.
2. Punonjësi i Shërbimit të Provës, gjatë kryerjes së detyrave të tij për mbikëqyrjen dhe asistimin e të mbikëqyrurit, deklaron të gjitha rastet e rënies së tij në konflikt interesi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

3. Punonjësi i Shërbimit të Provës është i detyruar të kërkojë heqjen dorë nga mbikëqyrja dhe asistimi i të mbikëqyrurit në rastet e konfliktit faktik e të vazhdueshëm të interesit me të dënuarin.
4. Deklarimi i konfliktit të interesit dhe kërkesa për heqjen dorë i paraqiten për vendimmarrje drejtorit të degës përkatëse të Shërbimit të Provës. Në rastet kur konflikti i interesit deklarohet nga drejtori i degës territoriale përkatëse, aktet i paraqiten për vendimmarrje drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Përmbajtja e kërkesës dhe e vendimit u njoftohet palëve në çdo rast, brenda afateve ligjore.

KREU III

MBËSHTETJA E SHËRBIMIT TË PROVËS

GJATË PROCESIT GJYQËSOR

Neni 14

Detyrimi për të paraqitur raport vlerësimi

1. Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, paraqet raport vlerësimi për të miturin në konflikt me ligjin, personin nën hetim, për të pandehurin ose për të mbikëqyrurin:
 - a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;
 - b) përpara vendimit të masës së shmangies dhe në përfundim të ekzekutimit të saj;
 - c) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;
 - ç) gjatë fazës së ekzekutimit të alternativës së dënimit me burgim në rastin e:
 - i. mbikëqyrjes së personit të dënuar;
 - ii. shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;
 - iii. përfundimit para kohe të periudhës së vënies në provë;
 - iv. përfundimit të dënimit alternativ apo përfundimit të përmbushjes së detyrimeve të caktuara;
 - v. mospërmbushjes së detyrimeve nga i mbikëqyruri.
 - d) në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Shërbimi i Provës paraqet në raportin vlerësues rekomandime të arsyetuara, sipas pikës 1, të këtij neni.
3. Punonjësi i Shërbimit të Provës, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të dënuarit, kryen vlerësime periodike dhe harton raporte periodike vlerësimi, në

përputhje me modelet standarde të miratuara nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Neni 15

Raporti i Shërbimit të Provës

1. Raporti i vlerësimit përmban të dhëna për:
 - a) familjen;
 - b) mjedisin shoqëror të personit;
 - c) formimin arsimor e profesional;
 - ç) sjelljen e përgjithshme dhe analizën e sjelljes;
 - d) rrezikshmërinë për përsëritje;
 - dh) sjelljen kundrejt viktimës;
 - e) çdo të dhënë që vlerësohet si e dobishme.
2. Shërbimi i Provës raporton në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht nga qëndrimet e prokurorisë apo të mbrojtësit, mendimin e tij.
3. Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën për pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës për hartimin e këtij raporti.
4. Raportet përpilohen sipas modeleve të standardizuara, të miratuara me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

KREU IV

VEPRIMET E SHËRBIMIT TË PROVËS PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE

Neni 16

Zbatimi i urdhrit të ekzekutimit

Shërbimi i Provës zbaton urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga prokurori bazuar në vendimin e gjykatës.

Neni 17

Administrimi i të dhënave gjatë zbatimit të urdhrit të ekzekutimit

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës, për çdo të mbikëqyrur, hap dosje personale, ku administrohen të gjitha aktet e nxjerra nga Shërbimi i Provës për të dënuarin gjatë procesit penal dhe ekzekutimit të vendimit gjyqësor përkatës.

2. Të dhënat personale të administruara gjatë periudhës së provës përpunohen e trajtohen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Dosja personale dhe përmbajtja e saj, pas përfundimit të periudhës së provës, trajtohet në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.
4. Çdo degë territoriale e Shërbimit të Provës, në përmbushje të detyrave funksionale, mban në formë shkruese regjistrat e mëposhtëm:
 - a) Regjistrin themeltar të personave të dënuar;
 - b) Regjistrin e kërkesë-ankesave;
 - c) Regjistrin e shkeljeve të planit individual të trajtimit;
 - ç) Regjistrin e ngjarjeve të rënda;
 - d) Regjistrin e organizatave jofitimprurëse, të institucioneve shtetërore ose joshtetërore që ofrojnë këshillim dhe asistencë të çdo forme për të dënuarit me alternativa të dënimit me burgim.
5. Format dhe përmbajtja e regjistrave të parashikuar në pikën 4 përcaktohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
6. Të dhënat e regjistrave të përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, trajtohen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 18

Veprimet që kryhen në zbatim të urdhrit të ekzekutimit

1. Veprimet që kryhen nga Shërbimi i Provës, në zbatim të urdhrave të ekzekutimit, janë, si më poshtë vijon:
 - a) Verifikimi dhe përcaktimi i kompetencës territoriale;
 - b) Vendosja e kontaktit të parë dhe realizimi i intervistës me të mbikëqyrurin;
 - c) Informimi për të drejtat dhe detyrimet që gëzon gjatë procesit të mbikëqyrjes;
 - ç) Hartimi i sistemit të vlerësimit të rrezikshmërisë;
 - d) Hartimi i programit individual të trajtimit në bashkëpunim me të mbikëqyrurin.
2. Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, joshtetërore dhe shoqërinë civile, merr masa për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në vendimin e gjykatës.

3. Rregullat për zbatimin e urdhrave të ekzekutimit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 19

Veprimet që kryhen në zbatim të vendimeve të parashikuara në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

1. Në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Shërbimi i Provës kryen veprime në zbatim të vendimeve për:
 - a) masën e shmangies nga ndjekja penale;
 - b) dënimet jo me burgim.
2. Rregullat për zbatimin e këtyre vendimeve përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 20

Detyrimet e të mbikëqyrurit në rast të ndryshimit të vendbanimit

1. I mbikëqyruri njofton me shkrim specialistin përgjegjës për mbikëqyrjen, për ndryshimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit. Në raste urgjente, i mbikëqyruri njofton paraprakisht, nëpërmjet telefonit ose me anë të postës elektronike, dhe më pas me shkrim, për adresën e vendit ku do të qëndrojë.
2. Në rastin e dënimit me qëndrim në shtëpi, procedurat për ndryshimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit bëhen sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.
3. Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të degës territoriale të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me çështjen, kjo e fundit i dërgon degës territoriale të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i të mbikëqyrurit, dosjen personale.
4. Rregullat më të hollësishme për arsyet e ndryshimit të vendbanimit apo vendqëndrimit dhe për mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 21

Përkujdesja për të mbikëqyrurin

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ndihmon dhe mbështet të mbikëqyrurin për riintegrimin social të tij, duke e referuar atë pranë

institucioneve dhe strukturave shtetërore kompetente për punësimin, strehimin, formimin profesional dhe shërbimet sociale, bazuar në informacionin e administruar gjatë të gjithë procesit dhe vlerësimin e personalitetit e të mjedisit social të të mbikëqyrurit.

2. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës mban kontakte të vazhdueshme me të mbikëqyrurin gjatë gjithë periudhës së vënies në provë dhe, kur kërkohet nga i mbikëqyruri, ofron mbështetje për përkujdesjen e mëtijshme edhe pas përfundimit të periudhës së provës, e cila i jepet vullnetarisht.

Neni 22

Mbështetja për viktimën

1. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës mbikëqyr zbatimin e detyrimeve për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga i dënuari gjatë kryerjes së veprës penale.
2. Specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës bashkëpunon me ndërmjetësues të licencuar, nisur nga referimi i rasteve dhe trajtimi i tyre përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, në përputhje me ligjin për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
3. Specialisti i Shërbimit të Provës, gjatë procesit të ndërmjetësimit, nuk ka detyrimin të informojë lidhur me fakte apo ngjarje për të cilat merr dijeni, me përjashtim të rasteve kur informacioni shërben për parandalimin e një vepre penale.

Neni 23

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata

1. Kur specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës konstaton mospërmbushje të programit të realizimit të mbikëqyrjes, ka detyrimin të verifikojë faktet dhe rrethanat penguese.
2. Kur faktet dhe rrethanat penguese për përmbushjen e detyrimeve ekzistojnë objektivisht, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës ka detyrimin të njoftojë prokurorin.
3. Kur faktet dhe rrethanat e parashtruara nga i mbikëqyruri nuk qëndrojnë, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës harton raport për mospërmbushjen me rekomandimet përkatëse drejtuar prokurorit.

4. Rregullat më të hollësishme në rast mospërmbushjeje të detyrimeve nga ana e të mbikëqyrurit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 24

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

1. Kur Shërbimi i Provës vlerëson se duhen zbatuar rregullat e Konventës Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht apo rregullat e përcaktuara në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara, bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e alternativës së dënimit me burgim.
2. Procedurat e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Shfuqizime

Vendimi nr.302, datë 25.3.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, shfuqizohet, pas miratimit të rregullores së re, të nxjerrë sipas këtij ligji.

Neni 26

Dispozita kalimtare

1. Nëpunësit aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, sipas rregullimeve aktuale në fuqi, vazhdojnë të gëzojnë të njëjtin status edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Punonjësit administrativë vazhdojnë të mbeten në detyrë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Procedurat e filluara për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të ndiqen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 27

Akte nënligjore

Ngarkohet ministri i Drejtësisë që, në zbatim të neneve 7, pika 2, 14, pika 3, 15, pika 4, 17, pika 5, e 24, pika 2, të nxjerrë aktet në zbatim të këtij ligji.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI